



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 23.7.2013, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kasumi, Musli Mehaj, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Fetah Salihu, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Valon Hiseni, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Shefki Gashi, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefqet Sylejmani, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Liridon Restelica, Besa Halimi - Zagragja, Lumnie Rama, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mehdiu dhe Sadri Ramabaja.

Munguan: Afërdita Veliu dhe Engin Beyoglu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE - së, përfaqësuesit e OJQ-ve, të mjeteve të informimit dhe përfaqësuesit e tri kompanive projektuese të projektplaneve rregulluese.

Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;
2. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Lindje";
3. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Qendër";
4. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Perëndim";
5. Raporti për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor 2013;

6. Propozimvendimi për ndalimin e ekspozimit të mallit jashtë lokaleve afariste dhe në sipërfaqe publike;
7. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve SOS Fshatit të Fëmijëve në Prishtinë;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

Para se ë fillonin me diskutimet rreth pikës së parë të rendit të ditës, **Shefki Gashi** ngriti shqetësimin e tij, duke thënë se ky shqetësim është edhe i një pjese të gjerë të qytetarëve të Prishtinës, ndoshta edhe të Kosovës, rreth propozimit të kryeministrit për formimin e Komunës së Vranjevcit - Kodrës së Trimave, për një territor i cili historikisht ka kontribuar për Prishtinën dhe Kosovën, një territor i cili është sakrifikuar në periudha të ndryshme kohore, një territorin të cilin ne si subjekt politik e kemi gjetur atëherë me një infrastrukturë me investime zero, e që sot të paktën është tejkaluar gjendja emergjente, dhe në kohën kur duhet atje të investohet diçka shumë më kapitale, që atje të krijohen vende të punës për ata njerëz, që të bëhet një zhvillim dhe një ngritje e standardit të atyre njerëzve atje, del një propozim dhe një ide që ajo pjesë të ndahet prej Prishtinës.

Ne duhet si këshilltarë, z. Kryetar, edhe ju të tjerët, ta formojmë një komision, ta bëjmë një deklaratë këtu, të dalim në terren t'iu shpjegojmë qytetarëve çka ata fitojnë dhe çka humbin. Andaj, i propozoj këtij Kuvendi të merremi me punën për të cilën jemi të votuar qe 14 vjet. Duhet të jemi pranë qytetarëve të Vranjevcit, tua shpjegojmë në detaje dhe le të deklarohen vetë ata nëse duan me ia lëshuar Prishtinën, Glllogovcit, Malishevës, Dukagjinit, Pejës, kujt të duan le të ia lëshojnë. Për ndryshe, për mua kjo është e papranueshme.

Kryesuesi tha se ky Kuvend e ka ngritur zërin sa e sa herë rreth Ligjit për Prishtinën, që është kategori kushtetuese, dhe mbesim në qëndrimet tona që i kemi për ligjin e Prishtinës. Njashtu edhe këtë propozim për komunën e re të lagjes "Kodra e Trimave" natyrisht se do ta kundërshtojmë.

Pika e parë

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në procesverbal, duke cekur se fjala *segregacional* nuk është shkruar drejt, andaj kërkoi që të korrigjohet.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Lindje", Bujar Demjaha, përfaqësues i kompanisë projektuese "A Design", bëri prezantimin e këtij projektoplani në mënyrë elektronike, duke elaboruar disa nga komponentet më kryesore të tij.

Për këtë projektplan, kryesuesi hapi diskutimin.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se si GP e kemi vlerësuar koordinimin e mirë me të tri kompanitë, hartuese të këtyre tri planeve rregulluese, që ka qenë në mënyrën më të mirë të mundshme, sidomos te pjesa e infrastrukturës rrugore, kanalizimit, ujësjellësit dhe pjesës tjetër, kështu që këtë koordinim ne e vlerësojmë. Ne i kemi dhënë disa vërejtje, konkretisht rreth infrastrukturës rrugore, që është edhe shqetësuese mos përdorimi i traseve rrugor ekzistuese, hapja e traseve të reja, sidomos nëpër prona private, të cilat po na kushtojnë shumë në momentin e shpronësimit, andaj dhe nuk di se a është bërë një analizë e saktë e kostos së zbatimit komplet të këtij plani. Ka edhe gabime të tjera të vogla, gabime teknike, ndoshta diku-diku edhe gjuhësore, apo edhe në aspektin e përkthimit, që është përdorur një material nga një gjuhë tjetër. Një vërejtje tjetër është mos koordinimi i koeficientëve të ndërtimit, sidomos prej tërësive në tërësi, pra një ngritje ose një ulje bukur e theksuar e koeficientave të ndërtimit.

Si GP do ta përkrahim dhe do ta votojmë që të shkojë për diskutim publik.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë projektplan e përkrahim që të shkojë në diskutim publik, por vërtetë janë disa proporcione në mes të parcelave, që u cekën edhe nga përfaqësuesi i LDK-së, ku dallojnë në masë koeficientet e ndërtimit dhe në etazhitet, andaj nëse shfrytëzohet sipërfaqja 50% e parcelës për ndërtim, kam një rezervë se mos do të ndodhë që Prishtina e re të jetë sikur Tauk-bahçja, të masakrohet ajo pjesë e gjelbëruar e lindjes. Mendoj se është vërtetë ndoshta për t'u diskutuar dhe për t'u analizuar në të ardhmen.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne në parim e përkrahim këtë projektplan që të dalë në diskutim publik.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se në këtë projektplan ka shumë gabime drejtshkrimore, ndërsa sa u përket çështjeve të tjera që u cekën nga parafolësit, pajtohem me ato vërejtje dhe sugjerime që i parashtruan, andaj edhe ne këtë projektplan e përkrahim, pasi që shkon edhe në diskutim publik.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne e përkrahim këtë propozim që të shkojë në diskutim publik, me ato sugjerimet që u dhanë. Edhe ne qëndrojmë pas asaj që gjelbërimi të ruhet aty ku ka mundësi. Është një përvojë shumë e keqe që një ndërtesë me 8,9 kate, mos ta ketë rreth veti një m² dhe është mirë të nxirret mësim prej atyre. Sigurisht se kolegët, profesorët, do t'i kenë parasysh këto.

Sugjeroi që të kihet parasysh mos të grumbullohen ndërtesat, sikurse janë grumbulluar në disa pjesë të deritashme.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se këto propozimvendime për lënien në dispozicion për diskutim publik të projektplaneve rregulluese të lagjeve, për fat të keq, unë së paku gjykoj se vijnë relativisht me një vonesë të theksuar. Për një pjesë të lagjeve, meqë po flas për të tri planet, dhe ka ndodhur ajo që e theksoi profesori paraprakisht. Degradimi i këtyre zonave nuk është çështje e projektuesve, nuk është çështje e arkitektëve, ajo pse shfrytëzohet shumë pak, respektivisht zbatohet shumë pak, projektregullorja është çështje e inspektoratit, mosfunksionimi i tij dhe i vullnetit politik për të shkatërruar qytetin.

Unë dua ta potencoj një fakt, se qytetarëve të këtyre zonave do t'iu kemi shumë borxh, për shkak se janë investuar miliona aty, ndërkaq milionat e investuar po hidhen pothuajse në shporta të mbeturinave, sepse po prishen shtëpi dykatëshe, trikatëshe, si të ishin shkrepse, dhe natyrisht ai investim qytetarit nuk do t'i kthehet asnjëherë.

Ajo çka mua më shqetëson, është fakti se pse nuk respektohen këto plane, pastaj insistimi që të shkohet me 15 kate, 8 kate, unë besoj që nuk veprohet më kështu në zonat e banimit në Evropë.

Ne bëjmë thirrje sërish që këto projekte të mos shkojnë në diskutim publik formalisht, t'i diskutojë Shoqata e arkitektëve. Jemi për atë që këto projektplane të mos keqpërdoren, por të shërbejnë në të mirën e qytetarëve.

Si GP e miratojmë në tërësi, pra projektplanin e parë të dytë dhe të tretë.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, e përshëndeti në mënyrë të veçantë kompaninë dhe profesorin për një punë të shkëlqyer që e ka bërë. Pa dyshim se zbatimi i këtij plani rregullues do të jetë më i lehtë dhe më i suksesshëm, pikërisht se kjo zonë është një mjedis pa ndërtime ilegale dhe zonë kryesisht e pa ndotur. Ne e përkrahim që ky plan të shkojë në diskutim publik, pastaj me vërejtjet, sugjerimet dhe plotësimet profesionale të na silltet në Kuvend për miratim.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, përfaqësuesi i kompanisë projektuese dha sqarime shtesë.

Njëzëri u miratua Vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Lindje".

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re -Qendër", Driton Lleshi, përfaqësuesi i kompanisë projektuese "Intech", në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij projektplani, duke elaboruar disa nga komponentët më kryesore të tij.

Për këtë projektplan, kryesuesi hapi diskutimin.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se e përgëzojmë kompaninë për punën që ka bërë. Të gjitha ato vërejte dhe sugjerime që i potencova më herët, pothuajse vlejné edhe për këtë projektplan, posaçërisht te rrugët ose te hapësirat gjelbëruese dhe objektet qeveritare ku janë të parapara, e ku ka mundësi të parashihen, që duhet të jetë në tokë komunale ose shoqërore, prapë le të mendohet dhe le të veprohet kështu, se vërtetë kemi probleme me shpronësimet.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se për dallim të projektplanit "Prishtina e Re - Lindje", në projektplanin "Prishtina e Re - Qendër", koeficienti është i kapshëm, ku vërehet se në këtë zonë nuk ka diferencë të madhe. Këtë propozimvendim e përkrahim që të shkojë në diskutim publik.

Besa Halimi-Zagragja, në emër të GP të PDK-së, tha se e përgëzojmë kompaninë për një prezantim mjaft të qartë edhe për anëtarët joprofesionistë të kësaj fushe. Desha vetëm të përmend një shembull të lagjes "Mati 1", në krahasim me ndërtesat që i ka përballë, banesat e bardha, është një kontrast negativ i kësaj që është ndërtuar tani, në raport me atë që është ndërtuar para shumë vitesh. Qasja metodologjike dhe parimet e planit të cilin e ka hartuar kompania, le për të besuar se nuk do të ndodhë diçka e ngjashme. Urojmë që mos të kemi

probleme në zbatim të kësaj, dhe të marrim impute të vlefshme gjatë shkuarjes në diskutim publik.

Këtë projektplan në parim e përkrahim.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se në parim edhe ne e përkrahim që të shkojë në diskutim publik.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu këtë projektplan, duke thënë se është mirë që aty ku janë zonat e objekteve afariste, të hyjnë edhe objektet kulturore, si ndonjë sallë e leximit dhe ndonjë objekt fetar.

Njëzëri u miratua Vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Qendër".

Pika e katërt

Për Propozimvendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Perëndim", Lulëzim Kabashi, përfaqësues i kompanisë projektuese "Ivanish Kabashi - Arcitects APE", në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij projektplan, duke elaboruar komponentët kryesore të tij.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë projektplan.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se e përgëzojë punën e kompanisë, dhe pa dashur me i përsëritur ato që i theksova për dy planet e mëhershme, pra janë të njëjtat vërejtje dhe sugjerime. Si GP e përkrahim që të shkojë në diskutim publik.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se për këtë projektplan kërkoj një sqarim, në dy karakteristika, faktikisht që janë në këtë Plan. Thuhet numri i etazheve nëntokësore nuk kufizohet! A është studiuar nëntoka aq shumë, saqë vërtetë mos me qenë e kufizuar?! Se në shumicën e blloqeve është kjo. Në shumicën e pamjeve që i pamë, gjelbërimi është shumë më i madh se që është në material, Në material gjelbërim thuhet 20 -25% kryesisht, ndërsa në pamjet që i pamë ishin më shumë se 20%. Kisha kërkuar prej kompanisë vërtetë këto të sqarohen më në detale.

Besa Halimi-Zagragja, në emër të GP të PDK-së, në parim e përkrahu, por pikërisht hapësirat e gjelbëruara në raport me shputën më bënë përshtypje, se nëse ngrihet P+8, pra ngrihet ndërtimi dhe hapësira mbetet e njëjta, a është menduar që të ndërmerret diçka për ta arritur hapësirën e gjelbëruar.

Astrit Hasani, në emër të GP të AAK-së, përgëzoi për punën e bërë të kompanisë dhe e përkrahu projektplanin që të shkojë në diskutim publik.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se këtë projektplan e përkrahim për të shkuar në diskutim publik, me ato sugjerime që i patëm edhe pak më parë, që krahas objekteve afariste, hoteliere, administrative, të jenë edhe ato edukativo-arsimore, fetare, në bashkëpunim me qytetarët dhe institucionet kompetente për edukim.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna rreth këtij projektplan, përfaqësuesi i kompanisë projektuese dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi kërkoi nga hartuesi i këtij projektplani që materiali në tërësi të rishikohet edhe një herë, në mënyrë që teksti final të jetë edhe i lektuar.

Njëzëri u miratua Vendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Projektplanit rregullues të lagjes "Prishtina e Re - Perëndim".

Pika e pestë

Lidhur me Raportin për situatën ekonomiko - financiare edhe zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor 2013, kryesuesi hapi diskutimin.

Tefik Mehmeti në emër të GP të LDK-së tha se edhe ky raport është vazhdimësi e raporteve sipas obligimit ligjor. Gjatë leximit të tij vërehet se ka një trend në rritje si te të hyrat, ashtu edhe te shpenzimet, nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Është për t'u përshëndetur trendi pozitiv i rritjes, ndërsa nëse kemi parasysh pjesën tekstuale tek investimet, si në infrastrukturën rrugore, shëndetësi, arsim etj., vërehet se ka një përshkrim pak të tepruar, por kuptohet që këto janë përshkrime të drejtorive sipas planifikimeve që i kanë bërë. Përndryshe, është një raport mjaft voluminoz, që jap një pasqyrë më të detajuar mbi të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në këtë gjashtëmuor.

Si GP këtë raport e përkrahim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se si GP e përkrahim, por kemi disa vërejtje, sidomos te infrastruktura dhe te ndërtimet. Në raport ka disa përshkrime, që në fakt projektet nuk janë realizuar, p.sh. thuhet se është përfunduar asfaltimi i rrugës Busi - Marec, ajo nuk është e asfaltuar, po ashtu rruga Viti- Bullaj është dashur të përfundojë. Ndërtimi i katër fushave të tenisit në Tauk- bahçe, posaçërisht rrethojat me beton, mendoj se janë të panevojshme. Po ashtu ende pa përfunduar projekti i kanalizimit në Tauk- bahçe, shtretërit e ujit të pastër janë mbushur me ujëra të zeza dhe tani aty kundërmon.

Me gjithë këto vërejtje rreth këtyre projekteve, këtë raport e përkrahim për miratim.

Besa Halimi -Zagragja në emër të GP të PDK-së tha se në parim nuk do të isha pajtuar me kolegun nga Grupi parlamentar i LDK-së, se ky është një material voluminoz dhe shumë i detajuar apo me të dhëna të tepruara. Përkundrazi, kjo nuk është një informatë, por është një raport për gjashtëmuorin, të dhënat dhe ajo transparenca e të gjitha të dhënave nuk e prish, por e rregullon, na sqaron më tepër. Unë pajtohem me këto të dhëna, bile kam disa vërejtje me qëllim që herën tjetër të jenë më të sakta, d.m.th. krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve në dy tabelat në këtë raport nuk është i saktë, sepse fjala është për kolonën e fundit, ku është përdorur një formulë jo konsistente, nuk është e njëjta formulë e përdorur në të gjitha të dhënat ku paraqitet ndryshimi për vitin 2012 dhe 2013. Edhe te shuma në rubrikën e realizimeve për 2013, te të hyrat tjera, meqë është kjo shumë mjaft e madhe prej 425 900 €, do duhej të mos formulohej si të hyrat të tjera, por të ketë d.m.th ose grupizim të atyre të hyrave ose të ketë emërtime më të shumta, sepse kjo është një shumë më e madhe. Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve është konstatuar se është 18%, por unë kisha dashur ta dijë se në Drejtorin e Arsimit a është tejkaluar apo nuk është arritur kjo përqindje, pra ka pas mundësi edhe për të dhëna të tjera.

Këtë raport në parim e përkrahim për miratim, me shpresë se gjithmonë do të jenë edhe më profesionistë në nxjerrjen dhe krahasimin e të dhënave.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se janë disa projekte të cilat po ndërtohen, por nuk po jenë edhe aq funksionale, si p.sh. mbikalimet që po ndërtohen në kryeqytetin tonë, duhet të kemi kujdes në çfarë forme dhe ku e kanë vendin ato. Për mbikalimin të Shkollës së Mjekësisë, ishte dashur të gjendej një formë tjetër, një mbikalim ndryshe, e jo kështu si e kemi sot, sepse nuk i konvenon askujt. Pastaj të pronat private, si në lagjet "Kalabria", "Kodra e Trimave" dhe pothuajse në të gjitha pjesë tjera të qytetit, ka ndërprerje të projekteve për shkak të problemeve pronësore. Ajo çka më tepër më intereson, investimet në arsim, vërtet kemi nevojë për shumë çerdhe, ndoshta edhe më shumë sesa për shkollat tjera, prandaj Drejtoria e Arsimit le të shikojë pak më qartë ku t'i harxhojë ato mjete që i dedikohen asaj.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne e përkrahim këtë raport, por me ato sugjerimet që i dhanë kolegët paraprakisht.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, tha se meqë na është prezantuar një raport mjaft i detajuar dhe i specifikuar dhe shumë transparent, e përkrahim për miratim.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV) tha se ky raport flet relativisht shumë, sidomos në investimet në fusha të veçanta në zërin e investimeve, si në infrastrukturën lokale, pastaj në arsim etj., megjithëse jashtëzakonisht shumë lë për të dëshiruar, si cilësia e ndërtimeve, e rrugëve e shumëçka deri tash.

Ajo çka mua si njeri i politikës më bënë përshtypje, është edhe emërtimet e disa rrugëve, siç është rruga "Xhafer Deva", që mban emrin e një fashisti etj. Po ashtu, thuhet se ndërtimi i rrugës "Isa Kastrati" është në tenderim, kur dihet se ajo rrugë praktikisht është e shkatërruar, nuk ka mundësi as të rregullohet, as të tenderohet. Investimet për ndërtimin e mbikalimeve janë projekte të gabuara, nuk shfrytëzohen, nuk përdoren, andaj kush do të japë llogari për këto. Të zëri i arsimit, është premtuar jashtëzakonisht shumë për çështjen e çerdheve, por nuk është investuar asgjë, gjithashtu edhe në disa investime në projekte shkollore, andaj përfitohet përshtypja nga ky raport se janë bërë investime kapitale, në fakt është bërë keqpërdorim kapital i parasë publike, sepse shumë prej punëve të kryera, në fakt janë të pakryera ose janë të kryera shkel e shko.

Në kulturë janë bërë pak investime. Bibliotekat e shkollave janë të zbrazëta, pa libra, projekti për renovimin e pishinës së Gërmisë, ndërtimi i rrugës "B", projekte të cilat është dashtë të kryhen, por shtyhen prej një sezoni në tjetrin, renovimi i Planit rregullues në Sofali ose në Lakërishtë, të gjitha këto po ripërsëriten, ku kot po bëhen shpenzime publike. Ky raport e ka një të mirë, na bënë të qartë se sa është keqpërdorur paraja publike.

Vjollca Dibra tha se në bazë të këtij raporti dhe hulumtimeve të fundit të UNDP-së dhe USAID-it, del se qytetarët e Prishtinës janë shumë të kënaqur me shërbimet që ofron Komuna e Prishtinës dhe besueshmëria e qytetarit është në nivelin e duhur.

Sa i përket të hyrave vetanake, në bazë të raportit shihet një ngritje shumë e dukshme dhe punë e suksesshme e drejtorive dhe administratës. Ky ndryshim vërehet edhe në krahasimin që e bëjmë në gjashtëmujorin e parë të vitit paraprak dhe këtij viti aktual. Me këtë analizë është marr edhe USAID-i.

Nga këto analiza është bërë e qartë se Prishtina me të hyrat vetanake, kontribuon rreth 40% të buxhetit total të të hyrave vetanake, d.m.th. vetëm Prishtina rritë këtë përqindje të buxhetit në pjesën e përgjithshme në nivel të Kosovës.

Ky trend pozitiv tregon përkushtimin e Komunës për zbatimin e projekteve të shumta kapitale, të cilat nuk janë keqpërdorime, por janë pikërisht kthime në investime kapitale nga këto të hyra vetanake të qytetarëve të Prishtinës.

Naim Makolli shprehu shqetësimin e tij lidhur me një fakt, se shumë zona rurale të Prishtinës ose disa fshatra, në këtë raport nuk figurojnë në asnjë projekt gjatë këtij gjashtëmujorit të parë, një ndër to është edhe fshati Marec. Kisha apeluar, meqë këtu është i pranishëm edhe Kryetari, që edhe një here të na premtohet që në këtë tremujorin e radhës të bëhet asfaltimi i rrugës Viti – Bullaj, meqë në lagjen “Bullaj” janë edhe disa shtëpi që jetojnë atje, janë edhe disa kulte fetare, të cilat e meritojnë vërtet që ajo rrugë të asfaltohet. Për çështjen e lagjes “Kodra e Trimave” i përgëzoj se këtu kemi disa rrugë që janë shtruar në këtë gjashtëmujor.

Lumnije Rama tha se në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, gjatë këtij gjashtëmujori është punuar në 15 projekte kapitale, të cilat janë cekur poshtë në material pa hyrë në rëndësinë e këtyre projekteve dhe nevojën e qytetarëve të komunës për prioritetin e projekteve të kësaj natyre. Ne duhet të konstatojmë se asnjë prej këtyre projekteve nuk është diskutuar në Komisionin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Nga kjo del se Komisioni në fjalë është formal dhe i pa rëndësishëm, mirëpo ne si këshilltarë duhet së paku të thirrëmi njëherë në muaj që të jemi prezent aty dhe të dimë për këto projekte që janë bërë.

Kryesuesi tha se është shqetësuese se këto komisione jo obliguese, janë jo funksionale në tërë territorin e Kosovës.

Me një abstenim (Sadri Ramabaja), u miratua Raporti për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investive të Komunës për periudhën janar - qershor 2013.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për ndalimin e ekspozimit të mallit jashtë lokaleve afariste dhe sipërfaqeve publike, në pika të shkurtra të pranishmit i njoftoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë propozimvendim.

Agim Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se duke punuar në interes të qytetarëve dhe konsumatorëve të komunës së Prishtinës dhe të kryeqytetit, me qëllim të mbrojtjes të të gjitha atyre që mund të dalin nga malli i ekspozuar jashtë lokaleve afariste dhe shitjes së tij në sipërfaqe publike, ku mund t'i ekspozohen kushtet e pa favorshme, siç janë nxehtësia, ftohtësia, insektet, gazrat e automjeteve pluhuri etj., GP dha vlerësim pozitiv në përmbajtjen e këtij vendimi dhe është për miratimin e këtij vendimi.

Aziz Pacolli kërkoi që ky vendim të jetë i plotfuqishëm edhe të zbatohet fuqishëm në terren.

Sadri Ramabaja tha se ky propozimvendim që do duhej të vinte ndoshta krejt në fillim të punës së këtij legjislacioni, vjen fare në fund. Kush është përgjegjës që tash e tri vjet qytetarëve iu është ofruar shërbim i tillë jashtëligjor, jashtë dispozitave të lejuara etj?! Është e vetëkuptueshme që ne, meqë është në shërbim të popullit, e përkrahim për miratim.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndalimin e ekspozimit të mallit jashtë lokaleve afariste dhe në sipërfaqe publike.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e mjeteve SOS - Fshatit të Fëmijëve në Prishtinë, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Agim Salihu.

Mejreme Berisha tha se ne jemi në dijeni për këtë institucion që është ndoshta i vetmi në Kosovë dhe ka shumë fëmijë jetimë të strehuar, por këtë shumë të mjeteve që e ka dhënë Komuna është e vogël, andaj kisha propozuar që kjo shumë të jetë më e madhe.

Njëzëri u miratua Vendimi për lejimin e mjeteve SOS - Fshatit të Fëmijëve në Prishtinë.

Pika e tetë dhe e nëntë

Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme

Mejreme Berisha paraqiti kërkesën e banorëve të lagjes afër parkut, gjegjësisht rr. "Edmond Hoxha", duke shtuar se banorët e kësaj lagjeje kanë ngritur një shqetësim rreth vendosjes së një grupi të nacionalitetit rom në shtëpitë e kësaj lagje, të cilët nuk janë banorë të lagjes. Prezenca e tyre ka shkaktuar shqetësim te banorët e lagjes dhe një pasiguri për shtëpitë e tyre nga vjedhjet që i bëjnë. At kërkojnë nga organet kompetente që të ndërmarrin masa për evitimin e këtij problemi.

Kryesuesi tha se ata njerëz janë të komunitetit rom, që zakonisht vijnë nga Shqipëria, dhe është mirë që kjo çështje të ngihet në Këshillin për siguri në bashkësi dhe të obligohet policia që ta ketë një kontroll më të shtuar për atë pjesë.

Aziz Pacolli kërkoi që të dilet në terren dhe të shikohet rrethoja e cila është duke iu bërë Tauk-bahçes me hekur dhe beton, që në masë janë duke e shkatërruar pjesën e gjelbërimit dhe kisha kërkuar nga drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që ta ketë parasysh se aty nuk ka nevojë për stadione të tenisit. Janë shumë katër terrene për tenis, andaj le të jenë dy terrene dhe të ruhet gjelbërimi.

Kërkesa tjetër është edhe për rrjetin e kanalizimit për pjesën e Sofalisë, e që ujërat e zeza derdhet në shtratin ende të pa përfunduar në Tauk-bahçe. Ai shtrat është shkatërruar dhe kundërmon. Faktikisht, projekti është bërë për lejimin apo shtimin e kanalizimit në gypa nëntokësor.

Astrit Hasani pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

Zejtaret e një pjese të lagjes "Dardania", konkretisht afër rrugës "Bill Klinton", pyesin se a do të rregullohet trotuari i kësaj rruge, pasi që komplet është i paprekur qe tri vite.

Kimet Zeqa ngriti çështjen rreth mosfunksionimit të Komitetit për shëndetësi, duke cekur se edhe përkundër moskompensimit, ka njerëz vullnetarë që do të kishin punuar për këtë komitet, që vetëm diçka të informohet Komiteti i shëndetësisë se çka po ndodhë në shëndetësi, pra tash e dy vite nuk është mbajtur asnjë takim. Me keqardhje dua ta ceku, se po kalon edhe ky mandat që nuk po mund të bëjmë për këtë komitet.

Vjollca Rizani pyetje për Drejtorinë e Inspektionit.

Lidhur me pyetjen e parashtruar, tha se në afërsi të rrugës “Xhavit Mitrovica” afër Dodonës, ka qenë një pjesë e gjelbëruar afër banesave dhe tani aty dikush është duke punuar vetëm të dielave. Këtë informatë e kam marrë nga banorët që janë aty afër dhe kërkuan që organet kompetente ta verifikojnë gjendjen.

Një informacion tjetër është se rruga e fshatit Shashkoc, një pjesë e saj e shtruar me asfalt, është shembur dhe paraqet rrezik për qytetarët. Kërkoi nga organet kompetente që të marrin masa për sanimin e saj.

Lumnije Rama ngriti një çështje, duke thënë se, meqë është sezoni i verës dhe ditëve të nxehta si zakonisht manifestohen problemet shëndetësore tek qytetarët që vuajnë nga

Sëmundjet kronike, edhe temperaturat e larta po ndikojnë në shëndetin e tyre, më intereson të dijë se institucionet shëndetësore që i menaxhon Komuna, sa janë të përgatitura dhe të mobilizuar në këtë drejtim.

Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se sa i përket ujërave të zeza në Tauk-bahçe, Komuna e ka hartuar detyrën projektuese për eliminimin e ujërave që po depërtojnë në Tauk-bahçe dhe është dorëzuar në prokurim. Presim që së shpejti do të shpallet tenderi për hartimin e projektit, sepse do ta përfshijë komplet atë zonë. Kemi bërë një sanim, sepse kemi ndërhyrë atje lartë përmes ujësjellësit dhe sot kemi marrë masa për ta pastruar shtratin. Sa i përket rrugës për Shashkoc, atje një fshatar e ka dëmtuar rrugën, e kemi konstatuar gjendjen dhe tash do të shohim se kush do ta sanojë atë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc.i dipl.